



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 483/2 prot.,

Datë 07.03.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “Montal SHPK & Biometric Albania SHPK” në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-57868-02-03-2023, me objekt “Lot. 1 Materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja spitalore (MM1)” me fond limit 12,246,921.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 13.02.2023, nga autoriteti kontraktor, Spitali Fier

Ankimues: BOE “Montal SHPK & Biometric Albania SHPK”
Rruga “Dervish Hima”-3 kullat, K3, A9/2

Autoriteti Kontraktor: Spitali Fier
Lagja “1Maj” Rruga “Invalidet e Luftes”, Fier

Në datën 06.03.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/2932 dhe me nr. 483 prot., datë 06.03.2023 e BOE “Montal SHPK & Biometric Albania SHPK”.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së BOE “Montal SHPK & Biometric Albania SHPK” nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”,

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të BOE “Montal SHPK & Biometric Albania SHPK”.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

“BOE “Montal” sh.p.k Tirane & “BIOMETRIC ALBANIA”, sh.p.k Tirane skualifikohen per arsye nuk kane paraqitur Marrëveshjen e noterizuar, sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht dhe Prokuren e posaçme te noterizuar sipas përcaktimeve te DST shtojca nr. 7 “formular i i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit” ku përcaktohet se : Shënim: Në rast se operatorët ekonomikë të kualifikuar janë bashkim operatorësh ekonomikë secili prej operatorëve ekonomikë duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mësipërm si dhe: a. Marrëveshja e noterizuar, sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht; b. Prokura e posaçme e noterizuar. c. vërtetimet e pasqyruara apo dokumentacionin mbi vetëdeklarimet e kërkuara në kriteret e përgjithshme të kualifikimit”

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 07.03.2023

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova